



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.503/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “FIDANI WATER ENERGY” Sh.P.K., me seli në Baballoq - Deçan, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokati Leotrim Sylja, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, me kërkesë për nxjerrje të aktit administrativ të urdhëruar me Aktgjykimin Nr. A.907/16 të datës 11.01.2019 konform nenit 34 pika 1.6 te Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ, me datë 03.04.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. **HEDHET** poshtë padia e paditësit “FIDANI WATER ENERGY” Sh.P.K., me seli në Baballoq - Deçan, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me seli në Prishtinë, me kërkesë për nxjerrje të aktit administrativ të urdhëruar me Aktgjykimin Nr. A.907/16 të datës 11.01.2019, sepse çështja është e gjykuar me Aktgjykim KA.231/22 të datës 12.11.2023 të formës së prerë.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

A r s y e t i m

1. Me datë 04.02.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës Departamenti për Çështje Administrative “FIDANI WATER ENERGY” Sh.P.K, me seli në fshatin Baballoq, Deçan, e përfaqësuar sipas autorizimit nga avokati Leotrim Sylja, ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.268/2020 kundër të paditurit Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, tutje (MMPH), me seli në Prishtinë, konform Ligjit mbi Konfliktin Administrativ, sipas

Aktgjykimit A.907/16 i datës 11.01.2019, me propozim që Gjykata të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar dhe të nxjerr vendim për zëvendësim të aktit administrativ.

2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 503/22.
3. Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata konstatoj se bëhet fjalë për të njëjtën çështje të ngritur ne padi për të cilën ekziston Aktgjykim KA.231/22 të datës 12.11.2023 i formës së prerë.
4. Me nenin 34 paragrafi 1.3 të LKA përcaktohet, *Gjykata e hedh poshtë padinë me vendim, nëse konstaton se ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.* Në paragrafin 2 përcaktohet *për shkaqe të parashikuara në paragrafin 1. të këtij neni, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.*
5. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.503/22, datë 03.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.